



Të nderuar Anëtarë të Këshillit të Investimeve,

Covid-19 e vendosi ekonominë Europiane, por jo vetëm, përballë disa sfidave të reja. Një nga sfidat kryesore, e cila po trajtohet sot nga vendet europiane, është diversifikimi i zinxhirit të furnizimit. Në këtë aspekt DIHA mendon se Shqipëria (dhe rajoni) duhet të identifikojë kapacitetet e veta, me qëllim pjesëmarrjen e saj në këtë ndryshim dhe orientimin e ekonomisë shqiptare drejt zinxhirit të ri të furnizimit evropian.

Disa nga rekomandimet tona janë:

1. Nxitja e eksporteve shqiptare në industrinë e lehtë, duke ulur barrierat doganore në importin e lëndës së parë. (Rasti konkret, në janar 2019 u vendos tarifë doganore për produktet plastike.)
2. Nxitja e produkteve ushqimore shqiptare duke thjeshtësuar procedurat për të patur akses në truall apo tokë bujqësore për investime të mëdha. (Rast konkret, një investim prej 5 milionë Euro pret prej dy vitesh marrjen e tokës bujqësore me qira për kultivimin e domates së vogël dhe majdanozit me destinacion Austrinë, Aquaponic)
3. Subvencionim në certifikim dhe konsulencë të produkteve të destinuara për tregun e BE, veçanërisht ato ushqimore (labororë për certifikim të produkteve BIO).
4. Investime infrastrukturore në rrugë, porte dhe aeroporte në funksion të zhvillimit të turizmit. Gjithashtu, duke qenë një sektor me rëndësi strategjike për vendin, është i nevojshëm edhe hartimi i një plani të mirëmbuar për mbështetjen e bizneseve që operojnë në fushën e turizmit për kapërcimin e situatës së vështirë të krijuar nga COVID-19.
5. Një nga rekomandimet e mbledhjes së kaluar të Këshillit të Investimeve do ta përsërisnim si një pikë shumë të rëndësishme: Përpilimi i një plani afatgjatë për lehtësimin e masave, por gjithashtu edhe një plan emergjence në rast rikthimi të Covid-19.

Efektet anësore të këtyre masave do të sillnin në terma afatmesëm dhe afatgjatë uljen e papunësisë si dhe një rritje të qëndrueshme ekonomike për Shqipërinë.

DIHA



Dear Members of the Investment Council,

Due to Covid-19, the European and global economy are facing some new challenges. One of the main challenges that the European countries are facing today is the diversification of the supply chain. In this regard, DIHA thinks that Albania (and the region) should identify its capacities, in order to participate in this change and to realign the albanian economy towards the new European supply chain.

Some of our recommendations are:

1. Promoting Albanian exports in the light industry, reducing customs barriers in the import of raw materials. (One concrete case, in January 2019 a customs duty was imposed on plastic products.)
2. Promotion of Albanian food products by simplifying the procedures for access to land or agricultural land for large investments (concrete case, an investment of 5 million Euros awaits for two years the lease of agricultural land for the cultivation of cherry tomatoes and parsley destined for Austria, Aquaponic)
3. Subsidy in certification and consulting of products intended for the EU market, especially food (laboratories for certification of BIO products).
4. Infrastructure investments in roads, ports and airports in order to develop tourism. Being a sector of great importance for Albania, it is necessary to develop a strategic plan for supporting the businesses operating in the tourism sector, so that they can manage the difficult situation created by COVID-19.
5. We would like to repeat one of the recommendations of the previous Meeting of the Investment Council, as a very important point. Compilation of a long-term plan for easing the measures, but also an emergency plan in case of an eventual return of Covid-19.

The side effects of these measures would in the medium and long term reduce unemployment as well as promote the sustainable economic growth for Albania.

DIHA